

# TË DREJTAT TUAJA DHE MBROJTJET NGA FATURAT MJEKËSORE SURPRIZË

Mary Free Bed<sup>®</sup>  
Rehabilitation

Kur merrni kurat urgjente ose kur kuroheni nga një ofruer shërbimesh jashtë rrjetit, brenda rrjetit të një spitali ose qendre kirurgjike ambulatorie, ju jeni të mbrojtur nga faturimi i saldosit (pagesa e diferencave). Në këto raste, nuk duhet t'u debitohet një shumë më e lartë se bashkë-pagesat, bashkë-sigurimet dhe/ose frankigja.

## ÇFARË ËSHTË “FATURIMI I SALDOS” (NGANJËHERË QUHET “FATURIMI SURPIZË”)?

Kur vizitoheni te një mjek ose një ofruer tjetër i kurave shëndetësore, mund të jeni të detyruar të paguani disa shpenzime nga llogaria juaj, si një bashkë-pagesë, bashkë-sigurim ose ndonjë frankigja. Mund të keni kosto shtesë ose duhet të paguani krejtësisht faturën nëse shkoni te një ofruer shërbimesh ose vizitoheni te një strukturë sanitare që nuk është në rrjetin e planit tuaj shëndetësor.

“Jashtë rrjetit” do të thotë ofruerit e shërbimeve dhe strukturat sanitare që nuk kanë nënshkruar një kontratë me planin tuaj shëndetësor për të ofruar shërbime. Ofruerit jashtë rrjetit mund të lejohen t'ju faturojnë diferencën ndërmjet asaj që paguhet sipas planit tuaj dhe shumës së plotë të tarifuar për një shërbim. Kjo quhet “faturim saldosit ose i diferencës së bilancit”. Kjo shumë ka mundësi të jetë më e lartë se kostot brenda rrjetit për të njëjtin shërbim dhe mund të mos llogaritet në lidhje me frankigjen ose me limitin vjetor të planit tuaj të shpenzimeve personale.

“Faturimi surprizë” është një faturë bilanci e papritur. Kjo mund të ndodhë kur ju nuk mund të kontrolloni se kush është i përfshirë në kurat tuaja shëndetësore - si p.sh. kur keni një urgjencë ose kur planifikoni një vizitë në një strukturë brenda rrjetit, por trajtoheni në mënyrë të papritur nga një ofruer i shërbimit shëndetësor jashtë rrjetit. Faturat mjekësore surprizë mund të kushtojnë mijëra dollarë në varësi të procedurës ose shërbimit.

## JENI TË MBROJTUR NGA FATURIMI I SALDOS PËR:

### SHËRBIMET E URGJENCËS

Nëse jeni në një gjendje mjekësore që është urgjente dhe shfrytëzoni shërbimet e urgjencës nga një ofruer ose strukturë sanitare jashtë rrjetit, maksimumi që mund t'ju faturojnë është shuma e ndarjes së kostos brenda rrjetit të planit tuaj (të tilla si bashkë-pagesat, bashkë-sigurimet dhe frankigja). Nuk mund t'ju faturohen me saldo këto shërbime urgjente. Kjo përfshin shërbimet që mund të merrni pasi të jeni në gjendje të stabilizuar, përveç nëse jepni miratimin me shkrim dhe hiqni dorë nga mbrojtjet tuaja për të mos u faturoar me saldo për këto shërbime pas stabilizimit.

## **DISA SHËRBIME NË RRJETIN NJË SPITALI APO QENDRE KIRURGJIKE AMBULATORI**

Kur merrni shërbime nga një spital brenda rrjetit ose qendër kirurgjike ambulatore, disa ofrues shërbimesh mund të jenë jashtë rrjetit. Në këto raste, pjesa më e madhe që ata ofrues mund t'ju faturojnë është shuma e ndarjes së kostos brenda rrjetit të planit tuaj. Kjo vlen për mjekësinë urgjente, anestezinë, patologjinë, radiologjinë, analizat në laborator, neonatologjinë, asistent kirurgun, spitalistin ose shërbimet e intensivistit. Këta ofrues shërbimesh nuk mund t'ju faturojnë saldon dhe nuk mund të ju kërkojnë të hiqni dorë nga mbrojtjet tuaja për të mos u faturuar saldon.

Nëse merrni lloje të tjera shërbimesh në këto struktura sanitare brenda rrjetit, ofruesit jashtë rrjetit nuk mund t'ju faturojnë saldon, përveçse nëse jepni miratimin tuaj me shkrim dhe hiqni dorë nga mbrojtjet tuaja.

**Nuk ju kërkohet asnjëherë të hiqni dorë nga mbrojtjet tuaja nga faturimi i saldos. Gjithashtu nuk ju kërkohet të merrni kura shëndetësore jashtë rrjetit tuaj. Ju mund të zgjidhni një ofrues shërbimesh ose një strukturë sanitare në rrjetin e planit tuaj.**

## **SHTETI I MIÇIGANIT KA GJITHASHTU LIGJE QË PARANDALOJNË FATURIMIN SURPRIZË.**

Ofruesi i shërbimeve jopjesëmarrës duhet të sigurojë në mirëbesim një vlerësim të kostos së kurave të shërbimeve shëndetësore që do të ofrohen. Një vlerësim në mirëbesim nuk merr parasysh rrethanat e paparashikuara, të cilat mund të ndikojnë në koston e kurave të shërbimeve shëndetësore të ofruara.

Ju gjithashtu keni të drejtë të kërkoni që kurat e shërbimeve shëndetësore të kryhen nga një ofrues i shërbimit që merr pjesë në planin tuaj të benefitit shëndetësor dhe mund të kontaktojë operatorin tuaj për të organizuar ato shërbime që do të ofrohen me një kosto më të ulët dhe për të marrë informacione mbi ofruesit brenda rrjetit që mund të kryejnë kurat e shërbimeve shëndetësore që ju nevojiten.

## **KUR FATURIMI I SALDOS NUK LEJOHET, JU KENI GJITHASHTU EDHE KËTO MBROJTJE:**

Ju jeni përgjegjës vetëm për të paguar pjesën tuaj të kostos (si bashkë-pagesat, bashkë-sigurimet dhe frankigjen që do të paguanit sikur ofruesi i shërbimeve ose struktura sanitare të ishte brenda rrjetit). Plani juaj shëndetësor do t'u paguajë direkt kostot eventuale shtesë ofruesve të shërbimeve dhe strukturave jashtë rrjetit.

### **Në përgjithësi, plani juaj shëndetësor duhet:**

- Të mbulojë shërbimet e urgjencës pa kërkuar që të marrë miratimin tuaj paraprak për shërbimet (i njohur edhe si "autorizim paraprak").
- Të mbulojë shërbimet e urgjencës nga ofruesit e shërbimeve jashtë rrjetit.
- Të bazojë atë që i detyroheni ofruesit të shërbimeve ose strukturës (ndarja e kostos) në atë që do të paguante një ofrues i shërbimeve ose strukturë brenda rrjetit dhe ta tregojë atë shumë në shpjegimin tuaj të benefiteve.
- Të llogarisë çdo shumë që paguani për shërbimet e urgjencës ose shërbimet jashtë rrjetit ndaj limitit të frankigjes dhe brenda rrjetit dhe shpenzimeve personale.

## **NËSE MENDONI SE JU KANË FATURUAR GABIM:**

- Kontaktoni Mary Free Bed Rehabilitation Hospital në këtë numër 616.840.8000.
- Numri federal i telefonit për informacione dhe ankesa në lidhje me faturimin surprizë është 800.985.3059.
- Vizitoni faqen e internetit [cms.gov/nosurprises/consumers](https://cms.gov/nosurprises/consumers) për më shumë informacione në lidhje me të drejtat tuaja sipas ligjit federal.
- Kontaktoni 833.ASK.DIFS (833.275.3437) nëse keni dyshime në lidhje me të drejtat tuaja sipas ligjeve të shtetit të Miçiganit.